

V E N D I M
Nr.261, datë 7.6.1993

PËR DERDHJEN E DETYRIMIT NDAJ SIGURIMEVE SHOQËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndërmarrjet, institucionet, organizatat dhe personat juridikë e fizikë privatë që bëjnë pagesën e punonjësve të tyre me listëpagesa të rregullta, bashkë me paraqitjen e çekut për tërheqjen e pagave të punonjësve për 15-ditëshin e dytë të muajit, do të bëjnë njëkohësisht dorëzimin e urdhërshirimit për derdhjen e detyrimit mujor ndaj sigurimeve shoqërore.

2. Të vetëpunësuarit, individë ose pjesëtarë në ortakëri, derdhjen e detyrimeve ndaj Sigurimeve Shoqërore do ta bëjnë sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara me udhëzim të veçantë të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Për zbatimin e këtij vendimi Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të lidhin aktmarrëveshje me Bankën Kombëtare Tregtare dhe Bankën e Bujqësisë e të Zhvillimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi